



Vendim Nr. 1 datë 29.01.2015

i Këshillit të Fakultetit të Ekonomisë, të Universitetit të Tiranës

Këshilli i Fakultetit të Ekonomisë , në mbledhjen nr. 1, të datës 29.01.2015

VENDOSI

1. Të miratojë dhe propozojë vërejtjet dhe sugjerimet në Projekt Ligjin

“PËR ARSIMIN E LARTË DHE KËRKIMIN SHKENCOR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”:

Duke vlerësuar inisiativën për hartimin e projekt ligjit të për arsimin e lartë, i cili ne dallim me ligjin Nr. 9741 date 21.05.2007, ka sjelle disa risi të rëndësishme si:

- Grante për zhvillimin, mësimdhënien dhe shkencën.
- Mundësia e kredisë studentore.
- Forcimi i strukturave administrative në institucionet publike.
- Autorizimi i institucioneve publike për të marrë kredi.
- Heqja e provimit të maturës si kriter për pranimin në arsimin e lartë.
- Synimi për një model NPM (Neë Public Managment)
- Rritje të autoritetit të administratorit.

Pas shqyrtimit nga ana jonë e draftit të paraqitur, kërkojmë që:

- Së pari, ekipi që ka punuar për reformën duhet të shprehet qartë nëse ky projekt ligj është i hartuar prej tyre apo është produkt i strukturave të ministrisë së arsimit.
- Pr/ligji i paraqitur kryesisht për aspektet që në këtë draft ligj përbëjnë risi, duhet të hartohet me kujdes dhe të bazohet maksimalisht në sugjerimet e dhëna gjatë procesit të dialogut të këtij draft ligji, si dhe të adresojë vakumet ligjore e ambiguitetin e mëparshëm që ka krijuar infleksibilitet të IAL, si dhe duhet të evitohet mbivendosjen e përgjegjëseve.
- Pr/ligji të shkruhet në gjuhë të mirëfilltë juridike (jo si udhezues) dhe inspektim juridik, të korrektohet nga ana gjuhësore. Duhet shtuar perkufizimet në fillim si universitet, kolegji, profesion i rregulluar, juri teknike, etj. Me shumë precizime ligjore nevojiten të bëhen për misionin e agjensive. Duhet shmangur perseritjet.

A- Komente të përgjithshme

1. Ligji përmban në shumë raste delegimin e rregullimit të këtij ligji, të problemeve shumë të rëndësishme (si format e financimit, menyrat e shpërndarjes së fondeve, kriteret e konkurimit, etj) tek Këshilli i Ministrave dhe tek MAS apo organizma të tjera të percaktuara në këtë ligj. Konkretisht, nga një shikim i ligjit, rezultojnë 34 raste në të cilat kërkohet që rregullimi të bëhet me VKM ose me udhëzim të MAS apo institucioneve të tjera.



2. Prishet qendrueshmeria e rregullimit të arsimit të lartë. Kjo sepse një pjesë e mirë dhe e ndjeshme e rregullimeve të arsimit të lartë do të jetë lehtësisht e ndryshueshme në varësi të qeverive dhe të ministrave apo drejtuesve të institucioneve. Kjo mënyrë lejon që Qeveritë e radhës të prishin vendimet e qeverisë paraardhese. Prandaj kërkohej që të evitohen delegimet dhe të paraqiten në këtë ligj rregullimet e kerkuara, të pakten në linjat kryesore. Për Ligjin të japë linjat, drejtimet kryesore të këtyre rregullimeve, kurse KM, MAS mund të bëjë vetëm udhëzimin konkret për realizimin e këtyre rregullimeve sipas përcaktimeve të bëra në ligj.
3. Në ligj parashikohen shumë struktura operacionale drejtuese, të cilat krijojnë struktura burokratike "të fryra". Këto struktura nuk janë të nevojshme në botën akademike, në dallim nga administrata publike. Burokracitë e tepruara nuk janë efektive dhe shkaktojnë kosto.
4. Në ligj paraqitet që kërkohej të realizohet pavaresia akademike dhe autonomia financiare, por në disa nene të paraqitura në të, kjo pavaresi apo autonomi nuk realizohet, cenohet, ose nuk është rregulluar qartë.
5. Ka paqartësi në përcaktimin e autoritetit drejtues të IAL ku rektori përcaktohet si autoriteti dhe përfaqësuesi më i lartë akademik i IAL duke krijuar konfuzion dhe përplasje Bordin i cili konsiderohet si përgjegjës për përmbushjen e misionit të IAL, misioni i cili lidhet me shumti me aspektin akademik e shkencor.

B- Komente specifike

1. -Mbi qeverisjen e arsimit të lartë në vend

Projekt-ligji parashikon disa ndryshime në qeverisjen dhe autoritetet e arsimit të lartë dhe ka decentralizuar procedurat administrative nga ministria në agjencitë përkatëse. Por **ka ngatërresa jo vetëm në kompetencat ndërmjet tyre por edhe në prezantimin e tyre**. P.sh. Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë merr përsipër shpërndarjen e fondeve publike (neni 15, pika 4 është bosh) dhe **garanton reditë** studentore, por është Ministria që **ndërmjetëson** kredinë (? , neni 121).

2. Mbi qeverisjen institucionale

Ka paqartësi në lidhje me kompetencat e emërimit dhe të shkarkimit. Konkretisht:

a-Ministri **urdhëron shkarkimin e rektorit** (ndërkohë që emërohet nga presidenti, neni 42/8);

b-Ministri mund të **shkarkojë një autoritet drejtues, por këtë e emëron rektori** (neni 45/3).

c-**Rektori nënshkruan kontratat e punës për personelin akademik (neni 42/5), edhe pse nuk i emëron apo zgjedh ai. Rregullimet në ligjin e meparshëm janë me të saktë dhe në përputhje me precedentet dhe frymen e ligjit, ku organi që emëron mund të bëjë shkarkimin por me miratim të një organi më të lartë duke kufizuar riskun e vendimarrjes jo të drejtë (Rektori e shkarkon presidenti me propozim të ministrit të arsimit, dekanin e shkarkon ministri i arsimit me propozim të rektorit, drejtuesit e njesive baze e shkarkon rektori me propozim të dekanit).**

3. Me tej vërejtjet sipas neneve janë:



Nenit 1, Pika 1.b (qëllimi i ligjit) mund të reduktohet, duke i kaluar disa elementë në Nenin 2, Pika1. Në veçanti, pjesë e misionit të arsimit të lartë duhet të jetë nxitja e drejtpërdrejtë e sipërmarrjes, përfshirë dhe sipërmarrjet sociale.

Neni 4. Roli dhe përbërja e Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL) është i paqartë dhe mund të çenojë autonominë e universitetit.

Neni 5. *E drejta per arsimim,* nuk ka kuptim ne vetvete, mund të shmanget.

Neni 6, pika **m,** permendet termi “Edukimi ne distance”, por nuk është në nënin e organizimeve të programeve të studimit (si forme e tij).

Neni 6, Pika1.ç. Te shtohet edhe “institucion i pavarur publik”.

Neni 7. Ministria përgjegjëse për arsimin.

Pika 2, fillon: “Ministria ka këto kompetenca.....etj”. Duhet precaktuar lidhur me çfarë i ka kompetencat, pra: “Ministria ka këto kompetenca lidhur me arsimin e lartëetj.

Pika 3.d. (Heqje e licencës së IAL pas auditimit). Nese eshte auditim financiar (psh. problem me Ligjin e prokurimit) pse te rrezikohet licensa, perderisa nuk ka te beje me procesin akademik? Duhet te percaktohet qarte kur rrezikohet vertet licensa.

Nenin 8. Të përcaktohet në këtë nen dhe jo me VKM mënyra e përzgjedhjes së anëtarëve të KALKSH, duke garantuar përfaqësimin e organizatave të studentëve dhe të punëdhënësve.

Neni 9, titullohet: “Krijimi dhe statusi”. Ne permbajtje nuk trajtohet statusi.

Neni 9, 10 dhe 11 mund te bashkohen sepse neni 11 percakton rolin e QSHA te prezantuar ne nenin 9, kurse neni 10 eshte i paqarte sepse nuk percakton tamam qellimin e QSHA, nuk eshte e qarte se cilat jane “sherbimet te treteve”. Organizimi sic eshte, paraqitet kaotik dhe jo i qarte.

Neni 10 mund te shmanget.

Neni 11 ka ne titull tarifat, por nuk percakton tarifat, thjesht ne paragrafin 2 specifikon se kush i percakton.

Pika 1. a. QSHA bën pranimin e studentëve. Të sqarohet i ndarë roli i QSHA nga ai i ILA dhe departamenteve në pranimin e studentëve.

Pika 1. f. Ku do të jetë kjo databazë? Thuhet që ofron shërbime dhe më poshtë institucionet janë të detyruar të japin çdo informacion.

Neni 12. duket sikur perserit permbajtjen e nenit 9.

Neni 14. Aplikimi dhe regjistrimi në institucionet e arsimit të lartë. Sugjerojmë që kuotat dhe kriteret e pranimit për të gjithë ciklet e studimit të përcaktohen nga vetë IAL, me përjashtim të fakulteteve/profesioneve me numër të programuar. Në Ligj parashikohen shume struktura operationale



drejtuese te cilat “fryjnë” me burokraci. Strukturat akademike janë të ndryshme nga ato të Administratës Publike. Burokracite e tepruara nuk jane efektive dhe rrisin koston.

Neni 15: pika 1.a. nuk kuptohet nëse IAL e pavarura publike e përfshihen ketu?

Pika 2 – AKFAL percakton kriteret e formulat e shperndarjes se fondeve publike. Ne Ligj duhet te percaktohen kriteret themelore te shperndarjes se fondeve publike.

Neni 17, Pika 4. Bordi i akreditimit. Mandati i anëtarëve të Bordit është 4 vjet. Duhet shtuar “me të drejtë ripërsëritje vetëm një mandat të dytë”. Të përcaktohet në këtë nen (dhe jo me VKM) mënyra e përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Akreditimit, duke garantuar përfaqësimin e organizatave të punëdhënësve.

Neni 18. Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor. Si caktohet Bordi drejtues i AKKSh-së, si organi më i lartë vendimmarrës? Po ekzekutivi i AKKSh-së si caktohet?

Pika 3. “AKKSh ben vleresimin e njesive bazë”. Nuk behet ne rang IAL ky vlerësim?

Pika 4. “AKKSH percakton ndarjen e ketyre fondeve mbi bazen e konkuresces” Kush i percakton kriteret e konkuresces? Nuk do të jetë normale që këtë ta bëjë po AKKSH. Kriteret bazë duhet të përcaktohen ne kete Ligj. Çfare kuptohet me *aplikantë*, sepse ne nenin 83 te po ketij projektligji percaktohen si te tille IAL-te.

Neni 19. Pika 2. “Konferenca e rektoreve” Kerkon sqarime me shume.

Neni 20 Organizimi i institucioneve të arsimit të lartë. Duhet të shtohet një nënçështje: “Një IAL ka të paktën 2 fakultete dhe cdo fakultet ka të paktën 2 departamente”.

Pika 3 nuk del qartë pse duhen krijuar Institucionet e pavarura publike të arsimit të lartë. Pse duhet një kategori tjetër IAL në kushtet kur dihet shumë mirë se ne kemi më shumë IAL për 1 milionë banorë se sa vendet e tjera të Evropës, rajonit etj.

Neni 20. Pika 2. Cfare forme juridike do te kene IAL publike? Ne piken 3 te ketij neni per institucionet e pavarura parashikohet te jene OJF.

Neni 22. nuk dihet pse futen keto forma te arsimit. Cfare ka kolegji ndryshim nga IAL? Vetem qe nuk zhvillon doktoratura?

Neni 25. Pika 6. “kriteret e pranimit dhe perzgjedhjen i percakton Departamenti”. Kjo bie ne kundershtrim me detyrat e QSHA. Duhet sqaruar. Mendojme se duhet te mbetet qe keto kriteret i caktojne departamentet me miratim te njesisë kryesore/IAL.

Neni 27, Pika 1: ‘IAL **mund** të krijojne Institute kërkimore-shkencore.....’ Pse përdoret fjala mund? Mund edhe të mos krijohet? Neni 4, paragrafi 3-ç: institucioni percakton vete tarifet....bie ndesh me Nenin 11, paragrafi 2 qe e percakton si funksion te QSHA percaktimin e tarifes.

Neni 28. Departamenti .Nocioni I departamentit eshte i konfunduar me nocionin qe perdoret ne universitete angleze apo te tjera. Duhet te sqarohet qarte sepse kjo percakton edhe ceshtje te tjera lidur me departamentet.



Pika 3 sugjerohet qe departamenti duhet të ketë të paktën 10 anëtarë prej të cilëve jo më pak se 4 me grada shkencore ose tituj akademikë.

Pika 5. “Departamenti percakton numrin e studenteve” Nuk kuptohet qarte, kete numër e percaktojne departamentet direkt apo njësia kryesore/ IAL me propozim te departamenteve?

Bashkerendimi midis departameneve. Cfare do te thote mareveshje midis departamenteve? Po nese nuk merren vesh departamentet?

Pika 6. A e ka të drejtën departamenti të përzgjedhë studentët fitues. Mbi cfarë kriteresh? Po te tjeret jashte kuotave te fakultetit?

“...ja delegon departamentit perzgjedhjen e studenteve” Mos do te ishte me mire qe te vihen afate kohore per cdo faze mbasi ka edhe aktore te tjere qe marrin pjese ne proces?

Neni 32. Filialet e institucioneve të arsimit të lartë. Sugjerojme se nuk duhet të lejohen IAL të kenë filiale. Eksperienca e deritanishme i shpërqendron stafet pedagogjike dhe i pengon në punën mësimore shkencore.

Neni 33. Hapja, mbyllja, ndryshimi i një institucioni të arsimit të lartë

Pika 4. Si do veprohet në se senati eshte kundra?

Pika 6. Cili e ka te drejten e propozimit per mbylljen e njesive bazë te IAL? Asambleja e njesise kryesore, Dekanati, Dekani? Duhet të sqarohet.

Pika 7. Pse jo nga shtet te tjera te zhvilluara si Japonia, Zvicra, etj?

Neni 36, Pika 3. njeh të drejtën e hartimit të rregulloreve nga vetë institucioni. Sugjerohet që hartimi i rregulloreve të jetë i detyrueshëm për mirëfunksionimin e IAL-ve. Gjithashtu, duhet të përcaktohet dhe struktura e këtyre rregulloreve (cfarë përshin).

Adminsitratori, meqë ka mjaft detyra funksionale administrimi dhe menaxhimi financiar, është e domosdoshme të ketë eksperienca te mëparshme në këto fusha. Preferohet që të ketë dhe arsim të fushës.

Neni 38, Pika 1. “Hapja dhe mbyllja e programeve behet miratim nga MAS”. Ministri i MAS dueht te mjaftohet me miratimin e hapjes te IAL por jo edhe te cdo program te ri qe hapet. Sugjerojme se do te ishte mjaftueshem miratimi nga Senati i IAL. Keshtu sigurohet autonomi e vertete akademike.

Pika 2. “Miratimi nga AKFAL e hapjes se nje program te ri studimi”Po nqs nje IAL publike hap nje program te ri studimi te financuar nga fondet e veta apo te huaja? “Kur program hapet pa miratim te AKFAL”. Cilat jane rastet kur hapet pa miratimin e AKFAL?

Neni 39 Autoritetet drejtuese dhe organet në institucionet e arsimit të lartë

Pika 3- Organi me i larte per permbushjen e misionit te institucionit të arsimit te larte duhet te jete Senati akademik.

Pika 4, është hallkë e tepërt administratori i njësisë bazë.

Pika 8, zgjedhjet duhet të zhvillohen çdo 5 vjet dhe për të gjitha instancat drejtuese duhet të qendrohet në detyrë vetëm një mandat gjatë gjithë karierrës akademike (Neni 42 Rektori, Neni 45 Drejtuesi i njësisë kryesore, drejtuesi i njësisë bazë). Kandidimi në këto poste nuk duhet të vijë nga persona jashtë IAL.

Neni 42, Pika 7. Nëse Rektori zgjidhet nga jashte rradheve te personelit akademik cili do te jetë statusi i tij pas mbarimit te mandatit? Do te shkoje ne punen ku ka qene apo mbetet staf akademik?

Pika 8. Duhet shtuar fjalet ”ne baze te rezultatit zgjedhor” kjo edhe për konformitet me rastet e tjera.



Neni 43, Pika 5. Funkcionet kryesore të Rektoratit duhet të jepen ne ligj dhe jo ne statutin e IAL.

Neni 44, Pika 4. **Asambleja e personelit akademik.** Kush do te jete organi qe harton dhe miraton vendimet kryesore financiare dhe akademike te Fakultetit? Deri tani eshte Keshilli i Fakultetit. Duhet te jepen ketu me sakte edhe me plote funksionet financiare dhe strategjike te asamblese te personelit akademik ose te parashikohet nje keshill apo bord adminsitrimi ne rang fakulteti.

Neni 45, Pika 5. Duhet patjeter te percaktohen ketu funksionet e Dekanit.

Neni 46, Pika 3. Duhet patjeter te percaktohen ketu funksionet e Dekanatit.

Neni 48 Drejtuesi i njësisë bazë.

Pika 2. Nuk duhet të zgjidhet nga asambleja e personelit akademik të njësisë, por nga personeli akademik i njësisë bazë.

Neni 49. Komisionet e përhershme. Në të gjitha rastet zgjidhen për një mandat dyvjeçar dhe duhet shtuar “me të drejtë rizgjedhje”.

Neni 49- në organizimin akademik dhe administrativ te IAL-ve , Roli i organit “Keshilli i Profesoreve” eshte zëvendësuar me organin “komisione te përhershme” që rregullohen nga neni 49. Sugjerimi: - të vazhdoje të funksionojë organi “ Keshilli i Profesorëve” dhe komisionet të strukturohen brënda këtij organizmi.

Neni 51 Përbërja dhe krijimi i bordit të administrimit.

“Bordi i administrimit në institucionet publike të arsimit të lartë përzgjidhen për një mandat pesëvjeçar” dhe duhet shtuar “me të drejtën e një rizgjedhjeje vetëm edhe një mandat të dytë”.

Pika 2. Përbërja e bordit te IAL. Ne fakt rezulton qe ne rastin e institucioneve buxhetore, bordi i administrimit do te kontrollohet nga MAS, pra nuk ka autonomi financiare ose ajo do te jete shume e kufizuar dhe e kontrolluar nga MAS.

Neni 52. Pika1. a. “Bordit i lihet miratimi i strategjise afatmesme” Cilës strategji, financiare, kërkimore...? Bordi i administrimit duhet te miratoje vetem strategjine financiare por jo ate akademike dhe kerkimore e shkencore, qe duhet ta kete senati i IAL.

Neni 54. Administratori i institucionit të arsimit të lartë

Pika 4. Administratori duhet të ketë arsimim të lartë, duhet të jetë së paku në nivelin “Master profesional”, dhe përvojë pune së paku dhjetë vjet nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e arsimit të lartë.

Neni 56. Pika 3. “.. administrator i njesise kryesore shkarkohet nga bordi i adminsitrimit”. Po me lart thuhet se emerohet nga Adminstratori i Intstitucionit.

Neni 57. Pika 1. Nuk eshte e qarte se kush do te hartojte buxhetin e njesise kryesore dhe kush e miraton ate dhe zbatimin e tij.

Neni 58. Administratori i njësisë bazë në institucionet e arsimit të lartë



Ky nen nuk duhet te jete fare. Nuk ka kuptim qe te kete administrator te departamenteve. Nuk mendohet se mund te kete departamente aq te medhenj sa te kene nje administrator te vacantë. Po ashtu nuk percaktohet asnje rregullim ne lidhje me marredheneit e administratorit te departamentit me administratorin e fakultetit . Duhet hequr ky pozicion. Nese do te qednronte do te ishin me vend disa ndryshime si vijon:

- Neni 58.2 - Pra Bordi I adminsitrimimit do te emeroje edhe administratoret e njesive baze,? Te departamenteve.
- Neni 58.3 – adminsiraotir I departamenve shkarohet nga Adminsitritori I instritucionit_. Cfare kuptohet me institucion? IAL apo Fakulteti???? Por nderkaq emerohet nga Bordi?? Ka kundershiti?
- Neni 59.2- Te shtohet: bashkëpunon me autoritetet dhe organet drejtuese të njësisë bazë për çështjet themelore të administrimit të saj.

Neni 61. Pika 1. “... trajtimin e vecante me VKM”. Edhe ne ligjin aktual eshte nje vendim i tille por nuk eshte bere ansjehere nga VKM. Duhet te percaktohet statusi I vencante ne ketë nen, ose te ngarkohet KM qe te nxjere kete VKM Brenda 3 muajsh nga dalja e Ligjit.

Neni 62 Pika 2 mbi kategoritë e personelit akademik thuhet saktësisht se: “Personeli akademik mund të jetë me orientim mësimor ose kërkimor-shkencor”. Nuk përcaktohet mënyra se si mund të kryhet kjo ndarje. Sugjerojmë se çdo pedagog duhet të kryejë të dy këto funksione në të njëjtën kohë, pra të hiqet kjo pikë.

Neni 64 Fitimi i titujve akademikë. 64/1 Për fitimin e titullit “Profesor” mund të aplikojë personeli akademik që gëzon prej së _____ vjetësh titullin “Profesor i asociuar” si dhe përmbush standardet shtetërore të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave. Si kriter ndarës nga kategoria doktor në prof asoc dhe profesor, mund të përdoret edhe nr i viteve total qe kandidati për titull akademik ka në fakultet.

Tek pika 2 mendojmë se “personat, të cilët nuk janë personel akademik pranë ndonjë institucioni” nuk duhet të lejohen të aplikojnë për tituj akademik sepse nuk ushtrojnë funksione akademike. Titujt akademik duhet të jenë vetëm për personelin akademik.

A mund te anashkalohen kriteret kohore ne ndarjen e titujve akademike në raste të veçanta? Psh kur veprimtaria botuese të jetë vetëm me një autor, disa monografi, dhe të jenë botuar në revista shumë të njohura ne botë apo konferenca në vende të zhvilluara?

Neni 65 mbi ngarkesat e personelit akademik është për momentin jo përcaktues. Është e domosdoshme që VKM-ja përkatëse të përcaktojë ngarkesën për çdo kategori në varësi të titullit dhe të orientimit (akademik apo kërkimor-shkencor). Mbulimi 2/3 ngarkesës nga staf i brendshëm e gjykojmë si pozitiv – por kërkon që në fakultetet e mëdha të shtohet stafi i brendshëm. Duhet analizuar nëse buxheti i shtetit e mbulon një rritje të tillë në organike.

Pika 1 dhe 2 - nuk ka referenca te mirëpërcaktuara per ngarkesat e personelit akademik me kohë të plotë. Duhet të përcaktohen kriteret qe duhet të zbatohen në kategorizimin e personelit akademik me orientim kërkimor - shkencor dhe atij me orientim mësimor. Terminologjia e përdorur si “orientim” nuk është referencë akademike. Gjithashtu, nuk evidentohet nëse kanë efekte financiare të ndryshme në këto kategorizime të personelit akademik. Gjithashtu, kjo terminologji bie në kundërshtim me pikënisje e referencës së vetë nenit mbi “personel-akademik”.



Sugjerimet për nenin 65,1,2 - *Staffi akademik i çdo njësie bazë (departamenti) të vazhdojë të funksionojë si një njësi e vetme, ku orientimi do jetë si kërkues shkencor ashtu edhe mesimdhënës.*

Pika 4 – raportet ndermjet veprimtarive duhet të përcaktohen me udhëzim të MAS. Mendojmë se duhet të jepen këtu kriteret kryesore të kësaj ndarjeje si dhe duhet të përcaktohet fakti se brenda çfarë kohe duhet të plotësohet udhëzimi nga MAS.

Neni 69 Kohëzgjatja e punësimit të personelit akademik .

Pika 3 Mbajtja e vendit të punës për “Personeli akademik, që mban titullin “Profesor” mund të shkëputet përkohësisht nga institucioni i arsimit të lartë, për një periudhë maksimale prej pesë vjetësh” duhet të jetë e parinovueshme dhe vetëm kur angazhohet në detyra Deputet i Kuvendit të Shqipërisë, Ministër, ose pozicione të tjera që me ligj konsiderohen si të barasvlefshme me këto pozicione.

Neni 71.1- Largimi nga puna duhet të bëhet dhe në përputhje me Kodin e punës dhe ligjet e tjera që rregullojnë marrëdhëniet e punës.

Pika 2. – Komisioni disiplinor - në këtë ligj nuk është përcaktuar ndonjë komision disiplinor dhe funksionet e tij.

Neni 72.1.b) - Duhet sqaruar se çfarë janë, çfarë kuptojnë këto studime me kohë të zgjatur.

Neni 72.5- Pranimi i studentëve duhet të shihet me detyrat e QSHA. Po ashtu duhet të përcaktohen këtu kriteret dhe standaret kryesore.

Neni 78, pika 4. Sugjerohet që studentëve më të mirë të Masterit Profesional, ti ofrohet si opion (në vend të provimit të përgjithshëm) dhe përgatitja e një diplome me karakter praktik në formën e nje analize me vlera praktike. Meqenese kjo kategori synon tregun e punës, por jo vetëm, nuk ka pse të jepet provim i përgjithshëm për këto studentë, por një punim diplome me specifika të karakterit praktik të paracaktuara.

Neni 79 Pranimi në programet e ciklit të dytë të studimeve Sugjerojmë se duhet të shtohet “*Në asnjë rast kuota për master shkencor nuk mund të përbëjnë më shumë se 1/3 e kuotave të studimeve master në një IAL*”.

Pika 4 – lejohet kalimi nga Master profesional në master shkencor – Me qëllim që të mos ketë subjektivizma është e rëndësishme të përcaktohet qartë kriteret e njohjes së krediteve.

Neni 80 Programet e ciklit të tretë të studimeve. Mendojmë se “Master Ekzekutiv” duhet të jetë program i ciklit të dytë. Ose duhet përcaktuar qartë se çfarë ofron. Mendojmë se studime të nivelit të tretë duhet të jenë vetëm studime doktorature.

Pika 4 - mbi studimet e doktoraturës, duke qenë se në nje pjesë të tij thuhet se”Ato kanë në themel kërkimin shkencor dhe veprimtaritë krijuese” nënkuptohet qartë që nuk do ketë shkollë doktorature.

Sugjerimet lidhur me këtë nen janë:

-të vazhdojë të funksionojë shkolla e doktoraturës me kriteret pranimit të përcaktuara qartë.

-studimet e doktoraturës të zhvillohen me kohë të plotë pranë departamenteve përkatëse dhe vetëm në raste të veçanta specifike (p.sh nëse kandidati është i punësuar pranë instituteve kërkimore) të pranohen doktorantë edhe me kohë të pjeshme.



Neni 81 - Pranimi në programet e ciklit të tretë të studimeve - Mendojmë se duhet shtuar pika 6 “Studentët e rregjistruar në ciklin e tretë janë ndihmës lektorë me kohë të plotë dhe me kontratë të përkohshme që përfundon me përfundimin e studimeve të tyre të doktoraturës”

Neni 82 Studimet e doktoratës

Pika 1. - Ka një kontradiktë në projektligj. Këtu del se vetëm IAL që ofrojnë studime të doktoratës mund të hartojnë projekte kërkimore e shkencore. Po të tjeret? Më lart në ligj duket sikur edhe çdo IAL tjetër mund të aplikojë për të marrë fonde për kërkime shkencore. Duhet sqaruar.

Neni 88. Pika 4. – Studimet në distancë - Nuk përmendet më parë kjo formë e studimeve.

Neni 90 Transferimi i studimeve - Tek pika 1, transferimet, duhet të theksohet se nuk mund të bëhen brenda përbrenda të njëjtit fakultet. Neni 90 e njeh transferimin e studimeve – por në përpupthje me Kartën e Bolonjës, duhet që të ketë udhëzime dhe nxitje të mobilitetit, të paktën brenda IAL-ve (nivel fakulteti e universiteti), dhe diplomim duke respektuar kushtin e 70% të përmbajtjes së programit, parashikuar në nenin 87.

Neni 91 Kohëzgjatja e studimeve - Për studimet e doktoraturës, ky nivel është i ulët (nisur nga eksperiencia). Sugjerohet që afati maksimal të jetë 6 vjet (pra 2fishi si për ciklet e tjera).

Neni 93 - Njohja e çertifikatave, diplomave, gradave dhe titujve të fituar në institucione të huaja. Tek pika 4. Duhet të shtohet në fund: “Procedura e njohjes nuk mund të zgjas më shumë se 2 muaj nga data e aplikimit”

Neni 99 - Institutet e “Kërkim Zhvillimit” pranë ministrive – Pse duhet të rregullohen me këtë ligj? Mund të dalin jashtë këtij ligji.

Neni 101, pika 1.c, për përdorimin e të dhënave parësore e dytësore të grumbulluara si rezultat i veprimtarisë së financuar prej fondeve publike. Duhet vendosur një politikë mjaft e kujdesshme e nivelit të përdorimit të këtyre të dhënave. Sugjerojmë të përfshihen edhe punimet e mikrotezave të ciklit të dytë: Master Profesional, Master Shkencor dhe Master Ekzekutiv në Bazën kombëtare e të dhënave për Kërkimin Shkencor.

Në kreun IX “STUDENTET”, sugjerojmë të të parashikohet krijimi i institucionit të Avokatit të të Diplomuarve (i pavarur ose brenda strukturës së MAS). Detyrë parësore e këtij institucioni do të ishte reduktimi i barrierave në drejtim të aksesit në tregun e punës, në përputhje me specialitetin e diplomimit. Për realizimin e kësaj detyre, Avokati i të Diplomuarve analizon situatën e të diplomuarve në tregun e punës dhe shkallën e aksesit në profesione të ndryshme. Gjetjet dhe rekomandimet ia komunikon MAS dhe KALKSH.

Komente të veçanta për Kreun XII -Pronat dhe Financimi i Arsimit të Lartë, nenet 114-122

1. Komenti i përgjithshëm është që për shumë çështje delikate delegohen tek KM dhe MAS rregullimet. Konkretisht janë 7 raste që delegohen tek KM dhe 2 tek MAS. Konkretisht:
 - a. Neni 116 pika 1.c) – caktimi i tarifës minimale dhe maksimale.
 - b. Neni 119 pika 2 – Përcaktimi i formulës për Fondet institucionale – KM
 - c. Neni 119 pika 6- Kriteret për studentët në nevoje – VKM



- d. Neni 120 pika 3- shpërndarja e Grantit kërkimor – shkencor – bëhet nga AKSH sipas kriterëve. Si përcaktohen kriteret?
 - e. Neni 121 pika 3 – Skema e kreditimit studentor me VKM
 - f. Neni 122 – Kushte për aplikimin për kredi – me VKM
 - g. Neni 125
2. Bordi i administrimit të IAL publike do të administrojë fondet e buxhetit për IAL. Por ky Bord, do të ketë maxhorancën e antarëve të caktuar nga MAS në rastin e IAL publike. Pra praktikisht do të vendosë MAS dhe jo IAL publike për përdorimin e fondeve. Duhet që shumica të jetë nga IAL publike e antarëve të këtij bordi.
 3. Në nenin 118 për grantin e politikave të zhvillimit të IAL nuk janë përcaktuar kriteret e renditjes së IAL publike? Thuhet që i cakton AKKSH? Duhet të caktohen kriteret kryesore themelore në këtë nen.
 4. Në nenin 118 nuk del e qartë nëse bëhet fjalë vetëm për IAL publike apo dhe ato private. Pika 2 shprehet për IAL publike, më vonë pikat e tjera japin të kutpojnë që përfshihen edhe ato jo publike.
 5. Neni 119 pika 2 flitet për një formulë që garanton barazi, etj. Por i lihet VKM përcaktimi i kësaj formule. Duhet që formula e ndarjes të përcaktohet këtu, sepse pastaj do të jetë lehtësisht e ndryshueshme sipas qeverive që vijnë e ikin dhe nuk do të ketë qendrueshmëri.
 6. Neni 119 – pika 3- Fondi i mbështetjes studentore – nuk kuptohet që do të mbështet të gjithë studentet e të gjithë IAL apo vetëm të studeneve të shkëlqyre dhe të tjeret vetëm të IAL publike. Gjykojmë që këto fonde duhet të mbështetin vetëm studentet e IAL publike, sepse IAL private janë private dhe të mbështesin vetë studentet e tyre. Ky rregullim mund të sjellë që Profesoret do nxiten të vënë nota të mira, që IAL e tyre të eprfitojë nga grantet për keat studente, duke terhequr kështu me shumë student në vitet pasuese. Kjo kompromenton cilësinë e procesit mesimor dhe të vlerësimit. (këtu konkurojnë njëllor IAL publike dhe ato private
 7. Neni 119 në pikën 7 përcakton që granti I mesimdhënie shpërndahet nga AKF- Por nuk përcakton se si me qartë??? Detyrimet e AKF, periudhen e shpërndarjes së Grantit, etj...
 8. Neni 120 – Granti I punës kërkimore-shkencore nuk sqaron fare se si do të bëhet konkurimi, për projekte, në rang institucioni, si do të perzgjidhen projekte me të mira etj. Nuk përcaktohen kriteret baze që do të shërbejnë AKKSH për të bërë këto perzgjedhje dhe të organizimit të procedurës së perzgjedhjes
 9. Do konkurohet në rang institucioni???? Po si do perzgjidhen nga institucioni projektet me të mira që do të çojnë për konkurim në AKKSH? Nuk thuhet asgjë në asnjë nen të këtij ligji??? Po ashtu ky grant është i caktuar për të gjithë IAL si publike dhe private. Në fakt duhet të bëhet një ndarje në favor të IAL publike, sepse fondet janë shtetërore. Po ashtu nuk tregohet se si do të shpërndahen grantet për doktoratën??
 10. Neni 121 – Kredite studentore - Gjithë ky nen duket një perpjekje për të futur si rëndësishëm “Kreditim studentor” por nuk thotë asgjë me shumë. Edhe sot, nëse një aplikant aplikon në një bankë he bind bankën mund të marrë një kredi për studime. Ligji nuk është evident ndonjë gjë tjetër në këto drejtim. Kështu si është thënë, duket sikur është bërë që të hapet rruga në parim dhe pastaj të jete KM që të përcaktojnë se si do të bëjnë këto skema. Pra, eviton debatet këtu. Kush bëhet garant, çfarë lehtësira do të kenë këto kredite.
 11. Neni 122 – Kredite për IAL publike - Nuk është e qartë se kur do të merren në parim këto kredite kush do të bëhet garant për to, etj??? Shumë e përgjithshëm për të vendosur. Duhet të jepen sqarime kryesore në ligj dhe jo thjesht në VKM
 12. Neni 125 – përcakton në pikën 1 kalimin e pronave të IAL publike në pronësi të tyre, por nuk jep një afat se kur duhet të bëhet kjo, Brenda çfarë date nga dalja e këtij ligji. Moslenia e afateve të sakta për çdo rast, krijon kushte epr zvarritje dhe mos realizim të synimit të këtij neni të ligjit



13. Neni 152 – percakton financimin e IAL (nuk percakton publike apo private, pram base te gjitha) aplikohet ne menyre te shkallezuar (??) nga viti buxhetor 2015? Por viti ka filluar tashme,? Buxhetet jane hartuar sipas burimeve dhe ligjeve qe ishin ne fuqi? Do te ndryshojne tani??? Nuk ka sqarime.

Neni 114 Parime bazë të financimit të institucioneve të arsimit të lartë nga Buxheti i Shtetit Tek Parimet bazë të financimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë nga Buxheti i Shtetit janë:

Duhet të shtohet pika d) Institucionet jopublike të arsimit të lartë mund të financohen vetëm për punë kërkimore shkencore me anë të procedurave të konkurimit

Tek **Neni 126 Krijimi dhe transformimi në institucion të pavarur publik të arsimit të lartë**

Nuk kuptojme se përse duhen krijuar.

Neni 126, - mbi “Krijimi dhe transformimi në institucion të pavarur publik të arsimit të lartë” duhet riparë në të gjitha pikat e tij. Të sqarohet se çfarë janë këto institucione të “**pavarura**”, cili është qëllimi i krijimit të tyre ;kujt i atribuohet titulli “themelues” i cili i transferon institucionit autonom të drejtën e pronësisë mbi pasuritë.”

Tek **Neni 129 Shpërndarja e fondeve nga Buxheti i Shtetit** Duhet theksuar “vetëm për IAL publike”

Tek **Neni 154**, pika 1, ka një fjali të panevojshme

KRYETARI I KËSHILLIT TË FAKULTETIT

Prof. Dr. Sulo HADERI



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I EKONOMISË

